

**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE**

**KRM “ UNITETI ” SH.A.**

**Mitrovicë**



**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR DEPONINË  
MBETURINAVE GËRMOVA, NË KOSHTOVË, KOMUNA E  
MITROVICËS**

**Mitrovicë, 15 Prill 2024**

---

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR DEPONINË E  
GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE REGJIONALE NË GËRMOVË, FSHATI  
KOSHTOVË KOMUNA E MITROVICËS**

**Parcela nr. 01974-7, Zona Kadastrale Koshtovë, Komuna Mitrovicë**

	<b>Emri</b>	<b>Hartueset e Raportit të VNM-së</b>
Aplikuesi	<b>Gazmend Morina, Kryeshef</b>	<b>Dr. Sc. Ibush Luzha</b> <b>Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari</b>
Investitori:	<b>KRM “ UNITETI ” SH.A.</b>	
Adresa:	<b>Ramadan Kelmendi Mitrovicë, a 40 000</b>	
Lokacioni i Deponisë	<b>Gërmovë - Koshtovë, Komuna Mitrovicë</b>	
Tel:	<b>028 516 555</b>	<b>+383 44 124 889</b> <b>+383 49 588 634</b>
Email:	<b>info.uniteti@gmail.com</b>	<b>ibushluzha@gmail.com</b> <b>Blerinabajraktari1@gmail.com</b>

**KRM “ UNITETI ” SH.A.**

**Dr. Sc. Ibush Luzha**

---

**Nënshkrimi**

---

**Nënshkrimi**

**Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari**

---

**Nënshkrimi**

**Mitrovicë, 15 Prill 2024**

---

**Përmbajtja:**

1.	HYRJE .....	1
1.1	Për Kompaninë.....	1
a)	Vendndodhja e Projektit .....	3
b)	Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit.....	5
c)	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit .....	6
d)	Përshkrimi detal i procesit të Punës .....	7
e)	Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së operimit .....	8
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së .....	10
3.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME .....	11
4.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT .....	12
4.1	Flora dhe fauna .....	14
5.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS .....	15
5.1	Ndikimet në Ajër.....	15
5.2	Ndikimet në Ujë.....	16
5.3	Ndikimi në Tokë.....	17
5.4	Ndikim në Biodiversitet.....	18
5.5	Ndikimi Social .....	18
5.6	Ndikimi Kulturor dhe Ekonomik .....	18
5.7	Ndikimi në Mjedisin Qëndror dhe Vendbanimet .....	18
5.8	Ndikimi në Ekonomi dhe Cilësinë e Jetës.....	18
5.9	Ndikimi në Mjedisin Bujqësor .....	19
5.10	Ndikimi në Komunitetin Lokal .....	19
5.11	Ndikimi mjedisor nga mbeturinat .....	19
6.	PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE .....	21
7.	PERSHKRIMI I MASAVE .....	23
7.1	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër .....	23
7.2	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë .....	24
7.3	Masat për mbrojtje nga zhurma .....	26
7.4	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë .....	28
7.5	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë .....	30
7.6	Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore.....	31
7.7	Masat rehabilituese .....	33

---

7.8	Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve .....	35
8.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI .....	37
9.	PËRFUDNIM.....	39
10.	ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMËN TABELARE: .....	40
11.	LITERATURA E PERDORUR .....	41

**Lista e Figurave:**

Figura 1.	Lokacioni i Deponise së grumbullimit të mbeturinave komunale KRM "UNITETI SH.A.....	2
Figura 2	Shtrirja hapësinore e Lokacionit të deponise se mbeturinave komunale KRM “UNITETI” Sh.a. ....	3
Figura 3	Lokacioni i Deponisë nga qendra e Komunes së Mitrovicës .....	4
Figura 4	Plani i Situacionit ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë .....	4
Figura 5	Situacioni i objektit të fabrikës.....	5
Figura 6	Deponia e mbeturinave "Gërmova" në Koshtovë, Komuna e Mitrovicë .....	6
Figura 7	Procesi i Punës së grumbullimit të mbeturinave .....	8
Figura 8	Ortofoto e deponisë së mbeturinave komunale Koshtovë, Mitrovicë .....	25
Figura 9	Mbulimi i mbeturinave dhe rere dhe zhavor - rehabilitimi i zonës së Deponisë në vitin 2022.....	35

**Lista e Tabelave:**

Tabela 1	Parcelat ku zhvillohet veprimtaria e Grumbullimit të mbeturinave .....	2
Tabela 2.	Pershkrimi i deponimit të mbeturinave sipas katalogut shtetëror.....	19
Tabela 3	vlerat e lejuara të zhurmës.....	28

## 1. HYRJE

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është një dokument i rëndësishëm dhe i nevojshëm për marrjen e Pëlqimit Mjedisor, nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, e cila është kusht për marrjen e lejes mjedisore dhe operimit të Aktivitetit të Deponimit të mbeturinave komunale. Përmes këtij Raporti të VNM -së do të përkufizohen të gjitha ndikimet që mund të paraqiten në lokacionin e deponisë dhe mjedisi jetësor duke pasqyruar mjedisin e gjerë.

Hartimi i raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis bëhet me qëllim që në mënyrë transparente të paraqitet ndikimi në mjedis në vendin ku gjendet deponia e grumbullimit të mbeturinave, në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit në mënyrë sa më të mirë.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis për deponinë e grumbullimit të mbeturinave e cila menaxhohet nga KRM “UNITETI” Sh.a. në lokacionin e quajtur Gërmovë, në një sipërfaqe prej 7 ha në ngastrën me nr. 01974-7 Zona Kadastrale Koshtovë, Komuna e Mitrovicës, është punuar duke u bazuar në projektin e ekzistues, gjendjen aktuale të lokacionit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit të fabrikës si dhe dokumentin teknik ekzistues. Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-së të Deponisë të Mbeturinave komunale kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis deri në kufijtë e lejuar. Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së operimit sepse Shoqëria Aksionare KRM “UNITETI” Sh.a. është e ndertuar në vitin 1992 dhe në vitin 2002 është bërë rihabilitimi i sajë, në mungesë të buxhetit KRM “UNITETI” Sh.a. deri më tani nuk ka pasur mundësi që të bëjë Raportin e VNM-së për shkak të Kostos së Lartë të dokumentacionit për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor nga MMPHI.

### 1.1 Për Kompaninë

KRM “UNITETI” Sh.a. Mitrovicë, ka një traditë pune shumëvjeçare. Kompania ka ushtruar veprimtarinë e vet që nga vitet e pasluftës së dytë botërore me emrin “Standard” deri me luftën e fundit të viteve 1998/99. Si çdo institucion apo edhe familje që u shkatërruan gjatë luftës së fundit të njëjtin fat e përjetoi edhe KRM “Uniteti” Sh.a.. Mirëpo, menjëherë pas luftës pikërisht me 27 Qershor 1999, me ftesën e Kryetarit të atëhershëm të Komunës së Mitrovicës z. Bajram Rexhepi i është bërë kërkesa stafit menaxhues të Kompanisë që të riaktivizoj shërbimin e ndërmarrjes, në po të njëjtën ditë është startuar dhe mobilizuar ish stafi i kësaj ndërmarrjeje

dhe në baza vullnetare ka filluar së vepruari. Që në fillim startuam si Ndërmarrje Publike Komunale ku me fillimin e aktivitetit të pasluftës ishin gjithsejt 47 (dyzeteshtatë) punëtor të ish stafit të ndërmarrjes. Në zhvillimet e mëtejme në bazë të rregullave të UNMIK-ut në fuqi u bë Regjionalizimi i këtyre ndërmarrjeve në të cilën u inkorporuan ndërmarrjet Vushtrri dhe Skenderaj në njësinë e Mitrovicës. Dhe transformimi i fundit është Korporatizimi i kësaj kompanie në Shoqëri Aksionare ku në bazë të rregullativave për momentin i vetmi Aksionar i këtyre Korporatave janë Kuvendet Komunale si Kuvendi Komunal i Mitrovicës me 61.4%, Kuvendi Komunal i Vushtrrisë me 28.6% dhe Kuvendi Komunal i Skenderajt me 10%. Në këtë aspekt i jemi mirënjohës edhe Ministrisë për Ekonomi dhe Financa në përkrahjen e shtimit të investimeve kapitale me qëllim të pajisjes me teknologji të re moderne, me qëllim të ngritjes së kualitetit të shërbimit dhe zgjerimit të rrjetit. KRM "Uniteti" Sh. A. në Mitrovicë është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike në Republikën e Kosovës. Zbatueshmëria e plotë e këtij ligji në KRM "Uniteti" Sh. A. ka filluar nga muaji Shtator 2009, ku tri Asambljetë Komunale kanë konstituuar Komisionin e aksionarëve dhe është zgjedhur Bordi i Drejtorëve të Kompanisë. Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh. A, vepron me numër të biznesit 70465104 dhe me numër fiskal 600241880 me seli në rrugën "Vëllezërit Dragaj" p.n Zona e shërbimit të KRM "Unitetit" SH. A përfshinë tri Komuna: Komunën e Mitrovicës, Komunën e Vushtrrisë dhe Komunën e Skenderajt.



Figura 1. Lokacioni i Deponise së grumbullimit të mbeturinave komunale KRM UNITETI SH.A.

Tabela 1 Parcelat ku zhvillohet veprimtaria e Grumbullimit të mbeturinave

Nr.	Nr. Parceles	Zona Kadastrale
1	01974-7	Zona Kadastrale Koshtovë, Komuna e Mitrovicës,

Ky raport është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojcën 4, pika 31. Po ashtu qëllimi kryesor i këtij raporti të VNM-së është identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis me qëllim të marrjes së masave të nevojshme për ti minimizuar ndikimet negative në Mjedis.

### a) Vendndodhja e Projektit

Lokacioni i Deponise se grumbullimit të mbeturinave e cila menaxhohet nga KRM “UNITETI” Sh.a. ndodhet në një sipërfaqe prej 7 hektar në ngastren me nr. 01974-7, Zona Kadastrale Koshtovë, Komuna e Mitrovicës. KRM “Uniteti” Sh.a., ndodhet në pjesën perëndimore të territorit administrativ të komunës Mitrovicës, në anën e majte në drejtim të komunës së Zubin Potokut.




Figura 2 Shtrirja hapësinore e Lokacionit të deponise se mbeturinave komunale KRM “UNITETI” Sh.a.




Figura 3 Lokacioni i Deponisë nga qendra e Komunes së Mitrovicës




Figura 4 Plani i Situacionit ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë



## b) Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

Deponia ka një sipërfaqe prej 7 hektarë me kapacitet prej 2 milionë metrash kub. Me rajonalizimin e ndërmarrjeve publike, kjo deponi për momentin në mënyrë të rregullt, shfrytëzohet për Komunen e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajit.


Shoqëria Aksionare KRM “UNITETI” Sh.a. me poshtë do ti paraqesim veçoritë fizike te këtij projekti:

### **Vend deponimi me sipërfaqe 7 Hektar m<sup>2</sup>:**

Përmbajnë:

- Vendi i matjes së mbeturinave (peshorja)
- Deponimi i mbeturinave
- Sistemi i Ajrosjes së deponisë
- Mbulimi i mbeturinave dhe Shpërndarja
- Sistemi i grumbullimit të ujërave nga deponia
- Hapësirat e parapara për zgjerim.

Deponia për grumbullimin e mbeturinave, është e vendosur ne nje siperfaqe prej 7 hektarësh në parcelën me nr. 01974-7, pasi qe parcela eshte ne pronesi te Komunes e po ashtu edhe deponia eshte nen menagxhimin e Komunes, lokacioni ne Fshatin Kosohtovë është përzgjedhur si lokacioni me i mire per deponimin e mbeturinave komunale.



*Figura 5 Situacioni i objektit te fabrikës*

Kapaciteti maksimal i deponise është 2.5 milion/m<sup>3</sup>. Mbeturinat grumbullohen krejtësisht të përziera pa ndonjë selektim, ku Mitrovica deponon mbi 80 tonë/ditë, Vushtrria 50 tonë/ditë dhe Skenderaj 55 tonë/ditë, mbeturinat mblidhen dhe dërgohen në deponi secilën ditë.



1

*Figura 6 Deponia e mbeturinave Gjermova'htë Koshtovë, Komuna e Mitrovicë*

Deponia përreth ka dy kanale për ujëra të reshjeve atmosferike që të mos hyjnë në deponi. Sistemi i trajtimit të ujit kullues të hedhurinave është me cikël të mbyllur d.m.th uji i hedhurinave kullohet dhe me rënje të lirë përmes drenimit ku bëhet kullimi i ujërve me sistemin e gypave, kalon apo rrjedh deri te basenet (rezervualet) dhe pastaj përmes sistemit të pompave uji i hedhurinave kthehet në deponi në formë spërkatje, pastaj në mënyrë natyrore avullohen.

### **c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit**

Me poshtë paraqesim përshkrimin e veçorive kryesore të fazës operative të Deponise se për menaxhimin e mbeturinave komunale për rajonin e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajt e ndërtuar në vitin 1992 dhe e rindërtuar në vitin 2002 nga Shoqëria “KRM “Uniteti” Sh.a. dhe përbëhet nga:

- Peshorja për matjen e peshës së mbeturinave në Kamion
- Makinerite për grumbullimin e mbeturinave,
- Makinerite për menaxhimin e mbeturinave në deponi,
- Deponia,

<sup>1</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=d8wVmtwgEPg>

- Basenet per trajtimin e ujerave te ndotura.

Sa i përket komponentëve kryesore, janë:

- Mbeturinat Komunale,
- Rera dhe zhavori per mbulim të mbeturinave.

#### **d) Përshkrimi detal i procesit të Punës**

Procesi i punës në deri tek deponimi i mbeturinave komunale e cila përfshinë disa hapa të rëndësishëm.

Këto hapa janë si vijon:

Procesi i punës për grumbullimin e mbeturinave komunale dhe menaxhimi i tyre në deponi përfshinë disa hapa të rëndësishëm për të siguruar që mbeturinat të trajtohen dhe përpunohen në mënyrë të sigurt dhe efikase. Këtu është një përshkrim i përgjithshëm i procesit:

1. **Grumbullimi i mbeturinave komunale:** Fillimisht, mbeturinat komunale grumbullohen nga banorët ose bizneset në zona të caktuara të qytetit. Kjo bëhet përmes shërbimeve komunale të grumbullimit të mbeturinave ose duke përdorur kontejnerë të dedikuar për këtë qëllim.
2. **Transportimi i mbeturinave:** Pas grumbullimit, mbeturinat transportohen në deponi. Kjo bëhet përmes kamionëve të specializuar të mbeturinave të dizajnuar për transportimin e tyre në mënyrë të sigurt dhe të pastrueshëm.
3. **Kontrolli i caktuar për mbeturinat e rrezikshme:** Para se të dërgohen në deponi, mbeturinat duhet të nënvizohen dhe të kontrollohen për përmbajtjen e mbeturinave të rrezikshme ose të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin publik. Këto mbeturina të rrezikshme trajtohen dhe përpunohen në mënyrë të veçantë për të minimizuar rrezikun.
4. **Depozitimi në deponi:** Mbeturinat pastaj deponohen në deponi të kontrolluar dhe të dedikuar për këtë qëllim. Deponitë duhet të përmbushin standarde të caktuara të mjedisit dhe të sigurisë për të minimizuar ndikimin e tyre negativ në mjedis dhe shëndetin publik. Mbeturinat mund të vendosen në një mënyrë të organizuar dhe të caktuar në deponi për të lehtësuar menaxhimin e tyre dhe për të zvogëluar rrezikun e ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit.

5. **Monitorimi dhe mbikëqyrja:** Pas deponimit të mbeturinave, procesi i monitorimit dhe mbikëqyrjes është i rëndësishëm për të siguruar që deponia të mbetet në përputhje me rregulloret dhe standardet mjedisore. Kjo përfshinë monitorimin e kualitetit të ajrit dhe ujit rreth deponisë, si dhe vlerësimin e ndikimit të mundshëm të deponisë në mjedis dhe shëndetin publik.
6. **Mbyllja dhe mbikëqyrja e pas-deponisë:** Kur deponia është plotësuar ose nuk është më në përdorim, procesi i mbylljes së deponisë fillon. Kjo përfshinë kujdesin për të mbyllur deponinë në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme për të parandaluar ndotjen e mjedisit dhe për të siguruar që deponia të mos jetë një rrezik në të ardhmen. Përveç kësaj, pas-deponia mund të mbikëqyrohet për një periudhë të caktuar për të vlerësuar ndikimin e deponisë në mjedis dhe për të vepruar në rastin e nevojës për të korrigjuar ose përshtatur masat e mbrojtjes së mjedisit.




Figura 7 Procesi i Punës së grumbullimit të mbeturinave

**e) Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit**

Me poshtë do ti përshkruajmë të gjitha emetimet e pritura gjatë fazës së operimit, të deponisë së grumbullimit të mbeturinave:

**Uji:** Kualiteti i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktiviteti i punës duke u bazuar ne masat e marruara nga kompania, nuk do te ndikoj negativisht gjate fazës se operimit, ndotja është minimale, kompania ka ndërtuar sistemin e kanaleve anësore te largimit te ujerave atmosferik te cilat trajtohen ne tri basenet e medha dhe perseri uji kthehet ne deponi.

**Ajri:** Procesi i punes mund të rezultojnë në emetime të ndotjes se ajrit. Kjo mund të përfshijë pluhura dhe gazra gjate levizjes se makinerive ne deponi.

**Dheu** – kontakti i ujërave siperfaqesore dhe rrjedhja e atyre nga mbeturinat mund te ndikojne negativisht ne tokë, por kompania ka ndertuar kanalet dhe drenazhet te cilat e grumbullojne ujin dhe e trajtojne ne basenet per trajtim me pas e perdorin per uljen e ndotjes nga pluhurat.

**Zhurma** – Zakonisht burimet e zhurmshme dhe mund të shkaktojnë ndotje akustike për komunitetin lokal edhe pse shtepite e banimit jane mbi 700metra, por duke analizuar lokacionin se ku është e vendosur deponia per menaxhimin e mbeturinave komunale, atëherë ndikimi i zhurmës do jete i përbalueshëm. Zhurma me e madhe do te shkaktohet nga levizja e makinerive ne deponi.

**Dridhjet** – Dridhjet të tokës - tërmete me intensitet të lartë nuk ka pasur, ka pasur lëkundje nga dridhjet e tokës, por pa pasoja në njerëz dhe dëme materiale. Këto dridhje kanë shkaktuar vetëm shqetësim.

**Flora dhe Fauna** – Ne rast se kemi derdhje apo shkarkim nga Ky aktivitet në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë mund të vije deri te ndikimet negative ne flore de faune por sipas KRM “UNITETI” SH.A ndikimi është minimal. Nuk parashihen ndikime të theksuara në florë dhe faunë.

**Ndikimet sociale dhe ekonomike** – Mund të thuhet se ky aktivitet nuk do të paraqes ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal edhe pse ka pasur ankesa nga komuniteti lokal por KRM “Uniteti” i ka evidentuar te gjitha problemet dhe shqetsimet. Ky Projekt ndikon pozitivisht në ambientin e komunave: Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj.

Llogaritja e llojit dhe sasisë së mbetjeve dhe emetimeve gjatë operimit të deponise duke përfshi vlerësimin e faktorëve të ndryshëm dhe marrjen në konsideratë të aktiviteteve specifike që lidhen me secilën fazë.

## 2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e fabrikës së prodhimit të mobileve me infrastrukturë përcjellëse dhe sipas projektit (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar.

Shtojca 1 e këtij ligji ,pika 8: Trajtimi i mbeturinave dhe ujërave të shkarkuar

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji nr. 08/l-145 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102,

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzim Administrativ (qrk) nr.08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave
- Udhëzim administrativ (qrk) nr. 06/2016 mbi kushtet për zgjedhjen e lokacionit dhe ndërtimin e deponisë së mbeturinave,
- Udhëzimi Administrativ MMPH 20/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave të Biodegradueshme,
- Udhëzim Administrativ (MMPHI) nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor.

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikojë për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

### 3. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Zgjedhja e lokacionit për deponi të mbeturinave komunale është një proces i rëndësishëm dhe kompleks, dhe ka disa alternative që mund të merren në konsideratë përpara se të bëhet zgjedhja përfundimtare.

Disa nga këto alternative parasysht janë:

1. **Studimi i Zonave të Mundshme:** Një hulumtim i gjerë dhe i detajuar i zonave të mundshme në një rajon është një hap i rëndësishëm. Kjo përfshin identifikimin e zonave që janë larg qendrave urbane, zonave të mbrojtura mjedisore, burimeve të ujit dhe zonave rezidenciale. Në këtë fazë, është e rëndësishme të përfshihet inputi dhe konsultimi me komunitetin lokal.
2. **Analiza Ambientale dhe Sociale:** Kryej një analizë të detajuar të impaktit ambiental dhe social që do të ketë një deponi në çdo zonë të mundshme. Kjo përfshin vlerësimin e ndikimit të mundshëm në ajër, ujë, dhe tokë, si dhe analizën e impaktit në komunitetin lokal, shëndetin publik, ekonominë, dhe aspektet sociale dhe kulturore të zonës.
3. **Kërkesat Ligjore dhe Regulloret:** Përparësi duhet të jepen zonave që përputhen me kërkesat ligjore dhe rregullat për ndërtimin dhe operimin e deponise. Kjo përfshin respektimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit, standardet për trajtimin e ujërave të ndotura, dhe licencat dhe lejet e nevojshme nga autoritetet lokale dhe qendrore.
4. **Alternativa Teknike dhe Teknologjike:** Vlerësimi i mundësisë së ndryshme teknike dhe teknologjike për menaxhimin e mbeturinave, duke përfshirë metodat e riciklimit, kompostimin, dhe trajtimin e avancuar të mbeturinave. Në disa raste, një zgjidhje e përshatshme mund të jetë një kombinim i disa teknologjive dhe metodash.
5. **Konsiderata Ekonomike:** Përfshirja e analizës kosto-efektshmërisë dhe vlerësimin e koston së çdo opsiioni të mundshëm, duke përfshirë kostot e ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së deponisë në të ardhmen. Gjithashtu, konsidero mundësinë e të fituarit nga riciklimi dhe përpunimi i mbeturinave për të zvogëluar koston dhe rritur të ardhurat.
6. **Konsultimi Publik dhe Përfshirja e Komunitetit:** Eshtë siguruar që procesi i zgjedhjes së lokacionit për deponinë të jetë transparent dhe të përfshijë konsultimin e publikut dhe përfshirjen e komunitetit lokal. Kjo përfshin organizimin e takimeve publike, konsultimeve me grupe interesash, dhe mendimeve të komunitetit përpara se të bëhet një vendim përfundimtar.

Përdorimi i këtyre alternativave dhe proceseve të përfshira në zgjedhjen e një lokacioni të përshtatshëm për një deponi të mbeturinave komunale do të ndihmojë në sigurimin e një zgjedhje të qëndrueshme dhe të përputhur me nevojat e komunitetit dhe mjedisit

#### **4. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT**

Bazuar në të dhëna, gjendja e mjedisit në komunën e Mitrovicës nuk është e mirë. Degradimi i tij është rezultat i shumë faktorëve të cilët janë me ndikim serioz në përbërësit kryesor të mjedisit: ajri, uji dhe toka. Të dhënat tregojnë se në Mitrovicë Jugore ekziston një ndotje e konsideruar e mjedisit me plumb dhe metale të rënda në saje të deponimeve të mbetjeve industriale nga e kaluara dhe shtresimit të pluhurit në sipërfaqen e tokës. Kjo ndotje arrin në formë pluhuri dhe ndotë tokën, ajrin, ujin e në këtë mënyrë edhe zinxhirin e prodhimeve ushqimore.

Komuna e Mitrovicës ishte dhe është njëra ndër komunat me komplekse me të mëdha të industrisë së metalurgjisë jo vetëm në vend, por edhe në rajon. Shfrytëzimi i minierave për metalurgjinë e rëndë në këtë vend ka filluar që nga viti 1930, kur Kompania Britanike Selection Trust lid, rikonstruktioi kompleksin “Trepça”, duke përfshirë zhvillimin e Fabrikës së baterive që përdorte plumbin. Komuna e Mitrovicës, si vend industrial, që nga ajo kohë e deri më sot është sfiduar me problemet e shumta mjedisore sidomos nga metalet e rënda. Shëndeti i popullatës është nën kërcënimin e vazhdueshme nga efektet e ndotjes e sidomos nga sedimentimi i Pb në gjak. Këtë rrezikshmëri e ka prezantuar edhe OBSH. Ndotja e mjedisit është pasojë e industrisë se mëparshëm të trashëguar nga sistemi i kaluar. Duke bërë krahasimin e hulumtimeve dhe studimeve të ndryshme për çështjen e mjedisit në këtë komunë rrjedh se gjendja aktuale e mjedisit është sfidues për banorët vendas dhe mbetet për të bërë shumë në të ardhmen për përmirësimin e saj. Sfidat që po ballafaqohet Komuna e Mitrovicës për mjedisin janë:

- Ndotja e ajrit,
- Kontaminimi i tokës nga mbetjet industriale të metaleve të rënda (si ato të Trepçës),
- Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimet,
- Mbeturinat,
- Transporti,
- Mbrojtja e natyrës.



**Ajri:** Monitorimi i cilësisë së ajrit në përgjithësi në Kosovë është i mangët për shkak të mungesës së pajisjeve dhe stacioneve monitoruese. Një monitorim i ajrit është duke u bërë nga një program i OBSH dhe IHMK-se.

**Deponitë industriale dhe urbane:** Për banorët e Komunës së Mitrovicës janë shumë shqetësuese deponitë e shumta nga mbetjet industriale dhe vendet e kontaminuara, që llogariten të jenë afër 12 sish. Këto vende tani janë të njohura si “Hot Spote” e që janë me një potencial të lartë të ndotjes. Deponi të tilla hasim te Tuneli i parë, Deponia te Kelmendi, Parku industrial etj., të cilat janë kërcënim i përhershëm i mjedisit dhe shëndetit të njerëzve. Këto deponi janë të kontaminuara nga metalet e rënda si mbetje industriale. Sipas një hulumtimi të OBSH-së për Komunën e Mitrovicës, thuhet se banorët e kësaj ane tejkalojnë sasinë e hekurit në gjak, e cila vije si pasojë e thithjes së ajrit me grimcat e hekurit që barten pikërisht nga këto zona me mbetje industriale. Rehabilitimi i këtyre deponive industriale kërkon kosto të larta, andaj për Komunën është e paarrtshme të realizohen këto projekte rehabilituese pa ndihmën e donatorëve të huaj dhe institucioneve qeveritare të vendit. Mbeturinat urbane bëhen në mënyrë të organizuar menaxhohen nga Kompania regjionale “Uniteti” për Mitrovicë. Sasia e deponimit të mbeturinave për banor kg/vit është 100 kg, ndërsa sasia e mbeturinave në ton 31.727 ton.

**Uji:** Ndonëse Komuna e Mitrovicës ka burime të mjaftueshme të ujit të pijes, megjithatë uji i pijes është problem për shkak se nuk ka rrjet të mjaftueshëm të ujësjellësit dhe në ato pjesë ku ka ujësjellës ka reduktime të mëdha të ujit. Vlen të përmendet liqeni artificial akumulues i Ujimanit (Gazivodes), përmes të cilit furnizohet me ujë popullata e këtij rajoni. Pjesa dërrmuese e fshatrave të Komunës së Mitrovicës kanë probleme dhe mungesë të ujit për pije, e sidomos fshatrat e rajonit të Shalës së Bajgores dhe pjesës së epërme të qytetit.

Si problem aktual mjedisor, sidomos për ndotjen e lumenjve, janë ujërat e zeza. Sistemi i kanalizimit ka shtrirje prej 72 km, duke larguar ujërat e zeza nga vendbanimet dhe shkarkimin e tyre direkt në lumë. Mbi 48 shkarkime të ujërave të zeza bëhen direkt në lumin Ibër. Efektet negative të derdhjes së ujërave të ndotura në lumin Ibër janë shqetësuese dhe në bazë të kësaj klasifikohet në klasën II, sipas kategorisë së ndotjes së lumenjve.

**Transporti:** Një problem në vete dhe me ndikim në mjedis është edhe transporti. Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta për gjendjen, sasinë dhe vjetërsinë e veturave mund të thuhet se trafiku rrugor është i ngarkuar, duke shkarkuar gazra të dëmshëm për shëndetin e qytetarëve. Mbrojtja e natyrës: Degradimi i natyrës, por edhe i lumenjve është prezent edhe në këtë komunë. Në veçanti është i shprehur degradimi i lumenjve, eksploatimi i zhavorrit nga gurëthyesit, që nuk janë të pakët në këtë komunë. E vetmja pjesë që mund të llogaritet si e ruajtur është natyra e

Shalës së Bajgorës. Për shkak të pozitës gjeografike dhe kushteve klimatike, që ka është vend tërheqës për turizëm dhe rekreacion. Në këtë lokalitet ka vende mjaft interesante, jo vetëm për turistë dhe pushues, por edhe për hulumtues dhe studiues të natyrës, për shkak të rariteteve të ndryshme të botës shtazore dhe bimore. Këtu ka monumente të natyrës, monumente arkeologjike, burime ujore dhe biodiversiteti.

Sa i perket zones hulumtuese ku është vendosur deponia e mbeturinave regjionale ajo është e rrethuar me male dhe bjeshkë dhe nuk shihet fare nga shtëpите e banuara, ujerat të cilat rrjedhin nga deponia shkarkohen në tri basenet e trajtimit ndërsa mbulimi i mbeturinave në shtresa bëhet me dheun dhe zhavorrin që ndodhet në rrethine. Para viteve 2008-2009 deponia ka shkaktuar ndotje të mëdha si në ujë dhe në tokë por pas vitit 2009 kompania i ka ndërmarr të gjitha masat duke i reduktuar të gjitha ndikimet si në ajër ujë dhe tokë.

#### **4.1 Flora dhe fauna**

Flora: Treva e Mitrovicës është mjaft e pasur me bimësi. Ajo ka sipërfaqe të mëdha pamjesh të ndryshme. Pos arave, livadheve, kullosave dhe sipërfaqeve malore, ku rriten bimë e drunë të ndryshëm, treva e Mitrovicës, një pjesë e rrethinës është e zhveshur. Pyje më të larta gjenden në Shalë të Bajgorës, kurse pjesa tjetër është sipërfaqe e pyjeve të degraduara, shkurrajat, çufrajat, që rriten spontanisht. Prej drunjtëve rriten: ahu, qarri, bungu, pisha, plepi, shelgje. Në Shalë të Bajgorës, për shkak të klimës, dimrave të gjatë e të ashpër e verërave të shkurtra e të freskëta, pos patates e tërshërës, të lashtat e tjera nuk rriten as nuk kultivohen. Megjithatë toka e butë buzë Ibër e Sitnicës etj. është mjaft pjellore dhe kultivohet gruri, misri, tërshëra, thekra, elbi, pjepri, shalqiri, speci, lakra, trangulli, jonxha etj. Vlen të theksohet se, përveç faktorëve tjerë, në dëmtimin e bimësisë pyjore ka ndikuar edhe hapja e rrugëve pyjore.

Fauna Dikur treva e Mitrovicës ka pasur një faunë mjaft të pasur. Në zonat kodrinore dhe malore kanë jetuar: ujku, dhelpra, lepuri, vjedulla, ariu, derri i egër, sorkadhe, pula e egër. Prerja e pyjeve pa kriter ka bërë që numri i tyre të bëjë shumë. Regjioni i Shalës së Bajgorës, dhe jo vetëm ai, ofron kushte për zhvillimin e gjuetisë dhe të turizmit të gjuetisë. Në regjionin e Mitrovicës në periudhën e fundit, për shkak të ndotjes së rrethit ekologjik, janë rralluar edhe kafshët shtëpiake. Numri i lopëve, deleve, dhive, kuajve, buallicave etj. Ka rënë shumë edhe numri i shpezëve: pulave, patave etj. Dikur në lumenjtë e Mitrovicës (Ibër e Sitnicë) ka pasur shumë peshq. Përgjatë këtyre lumenjve është peshkuar, mirëpo sot, për shkak të ndotjes së ujit, numri më i madh i peshqve është zhdukur. Në lumin Ibër dhe Sitnicë gjenden shumë lloje të peshkut si Krapa, Ngjala, Mlyshi, Trofta, Sykuqi, Pellemza, Linjaku etj. mirëpo janë shumë të

rrezikuara për zhdukje për shkak ndotjes së lumenjve nga Obiliqi dhe gurë thyesit në rrethin e Mitrovicës dhe nxjerrjes së rërës në këto dy lumenjve.

## 5. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS


Deponia e mbeturinave në komunën e Mitrovicës mund të ketë ndikime të ndryshme në mjedis, të cilat mund të përfshijnë aspektet si ndotja e ajrit, ujit, dhe tokës, si dhe impaktin në biodiversitetin lokal.

Këtu janë disa ndikime potenciale të deponisë së mbeturinave në këtë komunë:

### 5.1 Ndikimet në Ajër

Ndotja e ajrit nga deponia regionale e mbeturinave në Koshtovë, Komuna Mitrovicë është një shqetësim i rëndësishëm për shëndetin publik dhe mjedisin në përgjithësi. Depozita e mbeturinave prodhon një gamë të gjerë të substancave të dëmshme që mund të shpërndahen në ajër nëpërmjet proceseve natyrore të dekompozimit të mbeturinave. Këtu janë disa prej faktorëve që mund të shkaktojnë ndotjen e ajrit:

- **Gazi Metan (CH<sub>4</sub>):** Emetimi më i rëndësishëm nga deponia është metani, i cili është një gaz i gaztë shumë më i dëmshëm dhe së bashku me CO<sub>2</sub> përfaqëson gazrat serrë. Metani lirohet nga procesi i dekompozimit anaerobik i materieve organike në deponi. Ai mund të shpërndahet në ajër përmes "skarëve" të hapura, të cilat janë një pjesë e dizajnit të deponisë për të lejuar qarkullimin e ajrit nëpër mbeturina. Metani është më i dëmshëm kur përzihet në ajër dhe kthen atë në CO<sub>2</sub> sipas reaksionit:



- **Emetimi i Gazeve të tjera të dëmshme:** Përveç metanit, deponia mund të lirojë edhe gazra të tjerë të dëmshëm për shëndetin e njeriut, përfshirë:
  - a) **Amoniak (NH<sub>3</sub>):** Përdorimi i plehrave me përmbajtje të lartë të azotit mund të prodhojë amoniak, një gaz që mund të shkaktojë probleme të frymëmarrjes dhe ndotje të ajrit.
  - b) **Sulfidi i Hidrogjenit (H<sub>2</sub>S):** Një gaz i shpërthyes dhe me erë shumë të keqe, i cili mund të provokojë reaksione alergjike dhe ndotje të ajrit kur shpërndahet në atmosferë.
- **Ndotja nga kamionët:** Proces i transportit të mbeturinave nga qyteti drejt deponisë gjithashtu mund të shkaktojë ndotje të ajrit nëpërmjet gazrave të djegies, sidomos nëse kamionët që nuk janë të pajisur me filtrat e duhura për të mbajtur nën kontroll emetimet.

- **Ndikimi në Cilësinë e Ajrit Lokal:** Ndotja e ajrit në zonën përreth deponisë mund të ndikojë në cilësinë e ajrit në komunitetin lokal. Kjo mund të shkaktojë probleme shëndetësore për banorët, si reaksione alergjike, probleme të frymëmarrjes, dhe rritje të rrezikut për sëmundje të sistemit të frymëmarrjes.
- **Ndikimi në Zonën Lokale:** Depozita e mbeturinave është zakonisht e vendosur larg zonave rezidenciale, por gazrat dhe lëngjet e prodhuara mund të përhapen në zonën përreth. Kjo mund të shkaktojë shqetësime për banorët në këtë zonë, duke përfshirë ndjesi të erës së keqe, reaksione alergjike, dhe shqetësime për shëndetin e tyre.

## 5.2 Ndikimet në Ujë

Ndotja e ujit nga deponia regjionale e mbeturinave në Komunën e Mitrovicës është një shqetësim i rëndësishëm për cilësinë e ujit të burimeve të përdorura për pijet, bujqësinë, dhe përmbajtjen e ekosistemeve ujore në zonën përreth. Kjo ndotje mund të vijë nga leakate, që është lëngu i prodhuar nga deponia kur uji kalon përmes mbeturinave të deponuara, si dhe nga proceset e dekompozimit të materieve organike. Këtu janë disa ndikime potenciale të deponisë së mbeturinave në cilësinë e ujit:

- **Ndikimi në Burimet e Ujit të Pijshëm: Përhapja e Ndotjes:** Lëngjet e deponisë mund të përmbajnë kimikate të dëmshme dhe kontaminantë të ndryshëm nga mbeturinat, të cilat mund të përhapen në ujin e përdorur për pijet në zonën përreth. Kjo rrezikon shëndetin e njeriut dhe mund të shkaktojë sëmundje të lidhura me ujin.
- **Ndotja e Lumenjve dhe Përroit: Drenazhi i lëngjeve nga deponia:** Nëse rrjedhjes së ujit të ndotur nga deponia i lejohej të shpërndahet nën formë të pastruar, mund të drejtohet drejt lumenjve dhe përroit lokalë. Kjo ndotje mund të ndikojë në jetën e Flores dhe Faunës ujore në këto ujëra.
- **Ndikimi në Ekosistemet Ujore:** Ndotja e ujit mund të shkaktojë përkeqësimin e cilësisë së ujit dhe humbjen e biodiversitetit në ekosistemet ujore rreth deponisë.
- **Kontaminimi i Ujit për Bimësi dhe Bujqësi:** Nëse uji i ndotur përdoret për të korrur bimësi ose për ujitjen e kafshëve, mund të ketë ndikime negative në cilësinë dhe sigurinë e ushqimit. Kimikatet e dëmshme në ujë mund të akumulohen në prodhimet bujqësore.
- **Shqetësimet për Ujin e Pijes:** Ndotja e burimeve të ujit që përdoren për pijet në zonën përreth deponisë mund të shkaktojë shqetësime për shëndetin e banorëve, veçanërisht

për fëmijët dhe personat e moshuar. Ndotja e ujit mund të ndikojë në cilësinë e jetës së përditshme të banorëve, duke shkaktuar shqetësime për sigurinë dhe shëndetin e tyre.

### **5.3 Ndikimi në Tokë**

Ndotja e tokës nga deponia regjionale e mbeturinave në Komunën e Mitrovicës është një shqetësim i rëndësishëm për shëndetin e tokës, biodiversitetin dhe aftësinë e saj për të mbështetur jetën e bimësisë dhe faunës në zonën përreth.

Me poshte do ti paraqesim disa ndikime që ndodhin në toke nga deponia e grumbullimit të mbeturinave Regjionale:

- **Kontaminimi Kimik dhe Biologjik:**
  - **Rrjedhja e ujit dhe Ndikimi në Tokë:** Lëngjet e deponisë (leakate) mund të përmbajnë kimikate të dëmshme, si tërheqës dhe metale të rënda, që mund të kontaminojnë tokën kur infiltrohen nëntokës.
  - **Ndikimi në Strukturën e Tokës:** Materiet organike dhe kimikatet e dëmshme në deponi mund të ndikojnë në strukturën dhe cilësinë e tokës, duke e bërë më pak të përshtatshme për rritjen e bimëve dhe vegetacionit.
- **Ndikimi në Bimësi dhe Bujqësi:**
  - Ndotja e tokës mund të shkaktojë kontaminim të bimëve dhe frutave që rriten në zonën përreth deponisë. Kjo rrezikon sigurinë dhe cilësinë e ushqimit të prodhuar në këtë zonë.
  - Bujqësia në zonën përreth deponisë mund të ndikohet nga ndotja e tokës dhe ujit, duke bërë të vështirë ose të papërbalueshme për të kultivuar prodhime bujqësore të sigurta dhe të shëndetshme.
- **Gjurmimi Toksik dhe Ndikimi në Biodiversitet:**
  - Humbja e Biodiversitetit: Ndotja e tokës dhe zvogëlimi i cilësisë së saj mund të shkaktojë humbje të habitatit dhe reduktim të biodiversitetit në zonën përreth deponisë. Kjo mund të ketë efekte të mëdha për faunën dhe florën vendase.
  - Gjurmimi Toksik në Ekosistemet Tëra: Kimikatet e dëmshme dhe substancat e tjera të prodhuara nga deponia mund të gjurmohen në ekosistemet tërheqëse, duke shkaktuar rrezik për popullsitë e kafshëve dhe bimëve të ekuilibrit lokal.
- **Ndikimi në Sistemin Ekologjik Lokal:**

- Redukimi i Habitatit dhe Ekosistemit Tërheqës: Ndotja e tokës dhe ndërhyrja në mjedisin lokal mund të rrezikojë habitatet natyrore dhe ekosistemet tona tërheqëse, duke shkaktuar humbje të shprehur të biodiversitetit dhe mungesë të ekuilibrit ekologjik.

#### **5.4 Ndikim në Biodiversitet**

Humbja e Habitatit: Ndërhyrja në mjedis për ndërtimin dhe operimin e deponisë mund të shkaktojë humbje të habitatit për speciet e bimëve dhe të kafshëve të ekuilibrit lokal.

Ndikimi në Speciet e Ushqimit: Përveç humbjes së habitatit, ndikimi i ndotjes së ujit dhe tokës mund të ndikojë në popullsitë e peshkut dhe faunës tjetër të ujit rreth deponisë.

#### **5.5 Ndikimi Social**

Shëndeti Publik: Emitimi i gazrave të dëmshëm dhe kontaminimi i ujit dhe tokës mund të ketë ndikime negative në shëndetin e banorëve të zonës.

#### **5.6 Ndikimi Kulturor dhe Ekonomik**

Ndotja e mjedisit mund të ketë ndikim në aspekte të tjera të komunitetit, siç janë turizmi, bujqësia, dhe jetës kulturore të vendit.

#### **5.7 Ndikimi në Mjedisin Qëndror dhe Vendbanimet**

- **Ndikim në Estetikën e Mjedisit:** Prania e deponisë mund të shkaktojë një pamje jo tërheqëse dhe të pakëndshme për banorët dhe vizitorët e zonës, duke ndikuar në cilësinë e jetës së përditshme.
- **Zëra dhe Trafik:** Depozita e mbeturinave mund të shkaktojë zhurmë dhe trafik shtesë, veçanërisht në fazën e ndërtimit dhe shfrytëzimit të saj të përhershëm, duke shkaktuar shqetësime për banorët.

#### **5.8 Ndikimi në Ekonomi dhe Cilësinë e Jetës**

- **Përkeqësimi i Tregut të Pronave:** Prania e një deponie mund të zvogëlojë vlerën e pronave të pasurive të banorëve në zonën përreth, duke e bërë më të vështirë shitjen ose dhënien e tyre me qëra.
- **Turizmi dhe Bizneset Lokale:** Pamja e deponisë dhe shqetësimet për mjedisin mund të pengojnë zhvillimin e turizmit dhe bizneseve lokale, duke rënduar ekonominë vendase.

### 5.9 Ndikimi në Mjedisin Bujqësor

- **Kontaminimi i Tokës:** Rrjedhja e materieve të lëngëta nga deponia nëpër shtresa të tokës e kontaminon dheun, duke ndikuar në aftësinë e saj për të prodhuar ushqim të sigurt dhe të shëndetshëm.
- **Ndikimi në Kulturën Bujqësore:** Ndikimi në tokë dhe ujë mund të ndikojë në bujqësinë lokale dhe praktikat bujqësore tradicionale.

### 5.10 Ndikimi në Komunitetin Lokal

- **Mungesa e Përfshirjes dhe Konsultimit:** Nëse komuniteti lokal nuk ka qenë pjesë e procesit të vendimmarrjes për ndërtimin e deponisë, kjo mund të shkaktojë ndjenjën e mohimit dhe tensioneve midis autoriteteve dhe banorëve.
- **Shqetësime për Sigurinë dhe Sigurinë:** Një deponi e madhe mund të shkaktojë shqetësime për sigurinë për banorët, veçanërisht në lidhje me lëvizjen e kamionëve të mbeturinave dhe rrezikun e aksidenteve në rrugët afër deponisë.

Më lart u munduam të paraqesim një përmbledhje të ndikimeve të mundshme në mjedis të deponisë së mbeturinave në komunën e Mitrovicës. Është e rëndësishme të thellohem më shumë në analizën e detajuar dhe monitorimin e këtyre ndikimeve për të siguruar një menaxhim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm të deponisë së mbeturinave dhe në reduktimin e ndotjeve në kufijtë e lejuar nga ana e rregullatorit.

### 5.11 Ndikimi mjedisor nga mbeturinat

Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi i tyre - mbeturinat të cilat grumbullohen në deponie të mbeturinave regjionale në Komunën e Mitrovicës gjatë aktivitetit të fabrikës së mobileve, të ashtuquajtura mbeturinat komunale deponohen në kontejner dhe pastaj bartën me kamionë nga kompanitë e licencuar, të cilat i dërgojnë në deponit regjionale për trajtim të mbeturinave.

Tabela 2. Përshkrimi i deponimit të mbeturinave sipas katalogut shtetëror

Mbeturinat	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit
02 03 01	Llumrat nga larja, pastrimi, rrjepja, centrifugimi dhe ndarja	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
02 06 02	Mbeturinat nga agjentet e konservimit	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
04 01 01	Mbeturinat nga rrjepjet dhe prerjet	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë

10 01 01	Hiri nga fundi, llumi dhe pluhur i kaldase	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
10 01 03	Hiri fluturues nga forfat dhe druri i pa trajtuar	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
15 01 01	Ambalazhe Letre dhe kartoni	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
15 01 02	Ambalazhe Plastike	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
15 01 03	Ambalazhe druri	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
15 01 04	Ambalazhe metalike	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
15 01 05	Mbeturina Ambalazhe të përbëra	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
15 01 06	Ambalazhe të përziera	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
19 07 03	Ujërat nga deponitë, tjera nga ato te permendura ne 19 07 02	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 01 01	Letër Karton	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 01 02	Qelqi	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 01 08	Mbeturinat e Biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 01 10	Veshjet	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 01 11	Tekstili	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 01 38	Mbeturinat e drurit, tjera nga ato te permendura në 20 01 37	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 01 39	Plastika	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 01 40	Metalet	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 01 41	Mbeturinat nga pastrimi i oxhaqeve	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 01 99	Mbeturina tjera të paspecifikuara	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 02 01	Mbeturinat nga Kopshti që mund të kompensohen	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 02 02	Dheu dhe guret e rrugës	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 02 03	Mbeturinat e tjera jo biodegraduese	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 03 01	Mbeturinat e perziera komunale	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 03 02	Mbeturinat nga tregjet	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 03 03	Mbeturinat nga pastrimet e rrugëve	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 03 04	Llumet nga tanket septike	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 03 07	Mbeturinat e vëllimshme	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë
20 03 99	Mbeturinat komunale të pa specifikuara ndryshe	Jo të rrezikshme	Deponia rajonale koshtovë



Te gjitha mbeturinat komunale, urbane dhe te tjera deponohen dhe trajtohen në deponine e mbeturinave ne Koshtove, Komuna Mitrovicë.

KRM “ UNITETI”, Menaxhimin e mbeturinave e bene ne bazë te rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina.

## **6. PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE**

Vlerësimi i pasojave mjedisore nga deponia e mbeturinave komunale në Komunën e Mitrovicës përfshin metoda dhe qasje të ndryshme për të vlerësuar ndikimet në ajër, ujë, tokë, biodiversitet dhe shëndetin e njeriut. Këtu janë disa metoda të zakonshme të përdorura për vlerësimin e pasojave mjedisore:

